



Prishtinë, 16 prill 2019
Kodi i ZRRE: V_1135_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duku u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, Neni 46 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, Neni 47 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 dhe Neni 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT);
- Parimet për përcaktimin e tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (SHST) dhe taksave të kyçje;
- Vendimin V_1125_2019 të datës 28 mars 2019 për aprovimin e të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për OST/OT;
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit (SHST);
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Sistemit;
- Metodologjinë për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Tregut; dhe
- Kërkesën/aplikacionin e KOSTT SH.A për miratimin e tarifave të OST/OT në kuadër të Shqyrtimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, të dorëzuar më datën 10 prill 2019,

në seancën e mbajtur më 16 prill 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHEN** - tarifat për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut (KOSTT SH.A), për periudhën 01 prill 2019-31 mars 2020.
- II. Struktura e tarifave për KOSTT SH.A, e cila do të zbatohet nga data 01 prill 2019 është dhënë në tabelën e mëposhtme të këtij Vendimi:

Grupi tarifor	Elementi tarifor	Njësia	Tarifa
Prodhimi i kyçur në Transmetim	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.241
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.036
Prodhimi i kyçur në Shpërndarje	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	0.550
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.036
Operatori i Shpërndarjes	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.286
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.038
Furnizimi	Tarifa e SHST 400/220 kV	€/kW/vit	11.600
	Tarifa e SHST 110 kV	€/kW/vit	23.885
	Tarifa e Operatorit të Sistemit	€/MWh	1.286
	Tarifa e Operatorit të Tregut	€/MWh	0.038
	Tarifa e Fondit të BRE	€/MWh	3.198

ARSYETIM

ZRRE më datë 10 prill 2019 ka pranuar nga KOSTT SH.A, kërkesën/aplikacionin për tarifën e OST/OT.

ZRRE me rastin e vendosjes së tarifave për OST/OT, ka marrë parasysh dokumentet e përgatitura, lëshuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të ZRRE-së si në vijim:


- Raportin Konsultativ - Përshtatjet vjetore të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për KOSTT SH.A.(Prill 2019 - mars 2020), i publikuar në muajin shkurt 2019; dhe
- Raportin përfundimtar për Të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së, dhe përgjigjet ndaj Komenteve (prill 2019 - mars 2020), i publikuar muajin prill 2019.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe analizimit të raporteve relevante dhe pas shqyrtimit të komenteve të pranuar nga palët, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, i cili do të zbatohet nga KOSTT SH.A , duke filluar nga data 01 prill 2019 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d Kryesues


Besim Sejfi, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Ruzhiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT SH.A.) dhe
- Arkivit të ZRRE-së.